



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7991 /2026
Data: 21.08.2026

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e shtatë -VII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.07.2026, me fillim pune në ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Mehmet Ballazhi (Kryetar i Komunës), Lindita Ballazhi (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Arbenita Bajramaliu (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), Senad Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Bajrush Laçi (Udhëheqës i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë), Hyreman Kuka dhe Albina Meliqi (Përfaqësues nga Kompania Pastrimi).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026.
3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2025.
4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2025.
5. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërisë komunale.
6. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2026.
7. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2026 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
8. Informatë për sektorin e emergjencave.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi thekson:- Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti përfundimtar i komunës së Hanit të Elezit për vitin është në shumë prej 4,957,985.57 €, ku në këtë shumë përfshihen mjetet e ndara nga grantet qeveritare në shumë prej 3,877,962 €, projeksi i të hyrave vetanake në shumë prej 356,720.00 €, donacion nga Unioni Evropian për projektin dyvjeçar “A Smart System for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 141,903.98 €, bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026 në shumë prej 580,184.23 €, donacioni nga Këshilli i Evropës në shumë prej 1,101.68 €, mjetet e mbetura nga grantet, të cilat janë bartur vit pas viti, në vlerë prej 113.68 €. Të hyrat vetanake deri me datën kur po raportoj janë në shumë prej 101,455.62 € dhe në raport e kam sqaruar se nga muaji prill deri tash nuk kemi regjistruar të hyra për shkak se jemi në mungesë të zyrtarit të të hyrave, mirëpo tash jemi pajisur me qasje në SIMFK për regjistrimin e të hyrave dhe do të regjistrohen këto të hyra në mënyrë manuale. Bazuar në krahasimet e vitit të kaluar, kemi një ndryshim të të hyrave me një diferencë prej 971,628.98 €. Shpenzueshmëria totale e buxhetit për periudhën raportuese Janar – Qershor 2026, duke i përfshirë të gjitha kategoritë buxhetore, është në shumë prej 1,838,537.22 €. Materialin e keni në mënyrë të detajuar dhe, nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim, mund të parashtroni.

Menduh Vlasi thekson: sa i përket raportit ju përgëzojë se është një raport mjaft i qartë me krahasime të duhura që i jep raportit një pasqyrë më reale. Vërejtje kisha të të hyrat vetanake por ju i arsyetuat për shkak se kanë rënë në këtë gjashtë mujorë, është pozitive se kanë rënë edhe shpenzimet në këtë gjashtë mujorë që ju përgëzojë. Te investimet kapitale kam vërejtje që është 19.5 % dhe nëse vazhdoni kështu do të ketë suficitë si zakonisht.

Sead Vila thekson: ajo që më ra në sy edhe mu që për një periudhë gjashtë mujore as një e treta e buxhetit nuk është shpenzuar por arsyeshmëria shihet që për tre muajt e parë janë realizuar 30 % dhe uroj që deri në fund të vitit të shpenzohen mjetet dhe mos të shkojnë mjetet financiare suficit. Një bashkëpunim më i mirë duhet të jetë brenda ekzekutivit dhe komunitet për prioritet që janë për qytetarët. Në shikim të parë duket se është shumë dobët një lloj menaxhimi por arsyeshmëria e juaj është kështu dhe nuk do ta zgjasë më tepër.

Basri Dernjani thekson: unë e kam analizuar këtë raport dhe ju përgëzojë për punën të cilën e keni bërë. Edhe unë i kam shqetësimet për kategoritë buxhetore të cilat kanë pak rënie por sqarimi i juaj është shumë i arsyeshëm. Po ashtu dashta me ju përgëzuar edhe për kujdestaritë në shëndetësi sepse vitet e kaluara ka qenë shqetësuese ndërsa për këtë vit ishin shumë më mirë dhe shumë më në rregull.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: sikur çdo vit, obligim i zyrës kombëtare të auditimit është që ta bënë auditimin e organizatave buxhetore. Për vitin 2025 është realizuar auditimi i pasqyrave vjetore financiare dhe nga ky raport kemi pranuar pesë rekomandime, e që prej tyre katër janë të përsëritura dhe një rekomandim i ri. Rekomandimi i parë ka të bëjë me dobësi në përgatitjen e raportit vjetor financiar për vitin 2025. Rekomandimi i dytë ka të bëjë me nënvlerësimin e regjistrit të pasurisë në PFV. Rekomandimi i tretë ka të bëjë me keq klasifikimin e shpenzimeve. Rekomandimi i katërt ka të bëjë me vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimeve të tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari. Rekomandimi i pestë ka të bëjë me mos themelimin e njësisë së auditimit. Lidhur me këto të gjetura ne e kemi bërë një plan të veprimit për tu zbatuar këto rekomandime. Përveç materialit të cilin kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Bushi thekson: në këtë raport vërehen shumë parregullsi financiare, vonesa në pagesa dhe shumë parregullsi të tjera. Në raport vërehen që rekoamndimet e auditorit janë përsëritur nga viti në vit. Po ashtu Hani i Elezit e ka kaluar buxhetin mbi tre milionë dhe nuk e keni themeluar njësinë e auditorit të brendshëm.

Menduh Vlasi thekson: ka gati njëzet vite që e përcjelli raportin e auditimit nga themelimi i komunës dhe deri më tashë. Sipas mendimit tim ky është raporti më i keq që njëzet vite, është për të ardhur keq që komuna jonë me u radhitur në këtë pozitë që auditori me gjetur shkelje të ligjit, me gjetur keq menaxhim të buxhetit por kryetarë kur e ke pas marr mandatin e parë ke potencuar që do të menaxhojë me ekspertë të lamive dhe të kisha preferuar mbledhi bisedo me ta e nëse ka nevojë pse jo mos me i dërguar edhe në trajnim sepse të gjithë ditshëm nuk jemi asnjë pra me i dërguar në trajnim e mos me bërë gabime të tilla se janë shumë gabime që për mu absurde janë për shkak se nuk janë që nuk munden me u përmirësuar ato gabime. Në raport shënon pagesa e faturës aty është faktori njeri pra është zyrtari dhe duhet të merren masa ndaj atij zyrtari që nuk e ka bërë pagesën për shkak se është e përcaktuar me ligj që brenda muajit me u paguar fatura e jo mbi dyqind ditë. Auditorët kanë përdorur dy fjali që mu dukën shumë absurde por eksperti i çështjeve juridike potencojë që janë standarde por edhe unë e mora ashtu që janë standarde për shkak se në raport shënon se këto të gjetura janë ose nga mashtrimi që mu dukë shumë e rëndë dhe shënon që ose nga gabimi. Në KPF potencia që nga mashtrimi nuk besojë se nuk kemi zyrtarë që mundohen me mashtruar me gjëra të tilla e prej gabimeve që disa nuk e dinë e disa prej neglizhencës mundet me ndodhë por janë të gjetura që mund të përmirësohen, mirëpo fatkeqësisë më e madhe është që prej pesë të gjeturave katër janë prej vitit të kaluar dhe ju nuk keni vepruar hiq për me i përmirësuar. Në këtë vit është mirë që të uleni dhe ti përmirësoni sepse është turp edhe për mu si anëtarë i kuvendit dhe si qytetarë me dal një raport i tillë për arsye se raportin e auditimit e shohin të gjithë e jo vetëm na. Mos regjistrimi pasurisë është thjeshtë neglizhencë për shkak se komuna investon mija euro dhe nuk e regjistron si pasuri, e që për mu krejt këto të gjetura janë faktori njeri prej komunës që ose e ka bërë prej padijes, ose prej neglizhencës ose prej mashtrimit siç kanë potencuar në raport.

Resul Suma thekson: nuk pajtohem me parafolësin që potencon që gjithçka që është bërë në këtë qeverisje me e shpallur si ma e keqja prej krejt qeverisjeve. Unë përpara e kam raportin e auditorit për vitin 2021 ku parafolësi ka qenë në qeverisje dhe këtu janë tetë të gjetura dhe tetë rekoamndime nuk e i a është qyqi ma i keq apo qyqi i joni. Pajtona me parafolësin ku potencon që ne është mirë me kërkuar që na me hec përpara, me u përmirësuar në gjëra në të cilat kemi mundësi me u përmirësuar por kur bëhet fjalë për auditorin e brendshëm ti e dinë dhe je kanë në pushtet shumë kohë, e dini sa kushton dhe si mundet me u bërë. Deshta me cituar se përgjegjësinë e auditorit të përgjithshëm e auditimin e pasurive financiare të verifikueshme dhe në vitin 2021 potencon se keqdeklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse individualisht ose si tërësi në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marrura prej këtyre pasqyrave financiare, potencon që qoftë prej mashtrimit ose gabimit mund të harton një raport që përfshinë opinionin tonë, kjo thotë që është vetëm një opinion dhe nuk do të thotë që mundte me pasur diçka të pa rregullt dhe nëse ka diçka të pa rregullt ato munden me nis çështje penale. Deshta me i treguar se

para qytetarëve është mirë me informuar drejtë për çështjet të cilat kanë qenë në vitin 2021 dhe nuk janë më. Gjetja e vitit 2021 është gjetja e shpenzimeve në kategoritë ekonomike jo përkatëse pra bëhet fjalë për gjetjen numër një. Gjetja numër dy është mangësi në shënimet shpjeguese në pasqyrat vjetore financiare. Gjetja numër tre parregullsi në procedurat e rekrutimit të personelit. Gjetja numër katër mangësi në vlerësimin e tenderëve. Gjetja numër pesë parregullsi në procedurat e subvencionimit të projekteve. Gjetja numër gjashtë nënshkrimi i kontratave publike pa zotim paraprakë të mjeteve në SIMFK si dhe lëshimi i urdhërblërjeve pas skadimit të kontratave. Gjetja numër shtatë parregullsi në menaxhimin e pasurisë jo financiare, rritja e llogarive të arkëtueshme, vonesa në regjistrim dhe pagesa të obligimeve. Pyetje kam për parafolësin e cili raport i auditimit është më i keq a qaj që ke qenë ty pjesë e qeverisjes a qaj që është tash i cili i ka katër të gjetura, ndërsa më herët kanë qenë tetë.

Kryesuesi thekson: fjala që është përdorur në raport të auditorit si mashtrim është shprehje e cila nuk është përdorur vetëm në komunën tonë por është edhe në komunat tjera për shkak se është si shprehje e auditorit që e ka formuluar pra ishalla nuk e kemi atë mendje sepse mashtrimet janë të ndryshme dhe nuk e di pse e diskutoni këtë fjalë.

Menduh Vlasi thekson: nuk e di se pse nuk më ka ra në veshë kjo fjalë kur kam qenë në pushtet mirëpo mos me u paguar fatura dyqind e tetëdhjetë ditë është shkelje ligjore sepse ndoshta mund ti kesh dy të gjetura por janë të rënda dhe nuk e di a më kuptove se shifrat mos me u përputhur janë të rënda duhet të përputhen. Mos regjistrimi i pasurisë që edhe më herët ka ndodhë është e rëndë pse mos me u regjistruar dhe atë herë kam dhënë vërejtje aty ku duhet sepse kam qenë pjesë e ekzekutivit jo e kuvendit. Në tërë Kosovën është krijuar një far pozite që edhe ju keni bërë edhe ju keni vjedhë, mirëpo për atë është ndërruar pushteti për me u përmirësuar dhe unë dua me ju pa më mirë se sa na, pra këto janë vërejtje që duhet të i pranoni.

Mehmet Ballazhi thekson: çdo herë e kemi diskutuar që bashkëpunimi të jetë i ndërsjellët, reciprokë për komunën që duhet me qar përpara komunën dhe objektivat dhe vizioni është i secilit kryetarë dhe ish kryetari e ka pasur një vizion tjetër e unë e kam një vizion tjetër, mirëpo në kuadër të kësaj ju e dini kur kam qenë anëtarë i kuvendit të komunës kam ofruar bashkëpunim edhe pse i kam pasur papajtueshmëritë e mia por ju kujtohet kur e kam cekur çështjen e regjistrimit të pasurisë, po ashtu kemi diskutuar shumë çështje dhe nuk kemi bërë asnjë herë që po mundohesh ty me krijuar një far narrative për opinionin se këtu ka shkelje ligjore por shkelje ligjore nuk vjen prej auditorit por ai ka dhënë rekomandime dhe nëse potenconi shkelje ligjore mos bënë akuza të tilla se auditori mundet me iniciuar rast në prokurori për shkak se ata e përcaktojnë shkeljen ligjore. Në opinion kur e thoni, qytetari që të dëgjon ty mund të potencon se e ka potencuar një anëtarë i kuvendit të komunës se është bërë shkelje ligjore e duhet me shkuar në përgjegjësi por ne po flasim për rekomandime dhe pyetjen që ta parashtrij z.Resul Suma po ta parashtrijë edhe unë se a është një raport i auditorit me tetë gjetje më i mirë apo është një raport i auditorit me pesë gjetje, nuk po du me bërë krahasime se na kanë penguar shumë procese që janë shumë faktorë edhe politika qoftë edhe ajo qendrore por nuk deshta me hyjë edhe te pika e parë. Ju e dini se kur është alokuar buxheti dhe në tre mujorin e parë nuk e kemi pasur asnjë mundësi për me ekzekutuar asnjë pagesë se nuk kemi pasur buxhet e për veç problemeve të tjera siç jeni të njoftuar që kemi pasur probleme të rekrutimit të njerëzve tu e lënë punën siç i keni mbrojt ju p.sh me prokurimin dhe ta mbyllë zyrë dhe a me u fokusuar te auditori i brendshëm a duhet me u fokusuar te prokurimi që pastaj është pasojë e mos realizimi të implementimit të projekteve që ne i kemi. Krijone një mundësi dhe atmosferë të bashkëpunimit që me dalur prej krizave ku auditori mund ti gjejë si gjetje. Nuk ka komunë që nuk ka gjetje qoftë pak qoftë shumë se gjithmonë ka me pasur. Për çdo vit ka gjetje të auditorit për shkak se nuk shkojnë proceset ashtu siç na kishim dashur për shkak se nuk kemi një përvojë institucionale qoftë qendrore qoftë lokale. Nuk po mundem me kuptuar punën kur sheh njeri zi e terr që e ke përdorur shumë shpesh të padijshëm dhe është shumë cinike këtë me potencuar sepse është shumë e pa pranueshme si etikë parlamentare por mundon me pasur rekomandime ndaj neve dhe nëse nuk kishim bashkëpunuar atëherë mundeni me potencuar se e patët mundësinë por erdha edhe në zyre dhe me potencuar se kryetarë kam qenë shumë kohë në qeverisje dhe i kam këto përvoja por nëse ndonjë herë ta kam mbyll derën dhe nuk ta kam ofruar mundësinë me bashkëpunuar ty dhe të tjerëve pajtona se po më doket që po keqpërdoret dhe po shfrytëzohet foltorja apo mikrofoni se për me dëgjuar se dikush po potencon diçka dhe nuk ka problem edhe këtë bëne por politikisht nuk besojë që fitoni ndonjë poenë më shumë. Nëse ka diçka për me rregulluar këtë çështje hajdeni në zyre se është qelë dhe i diskutojmë.

Menduh Vlasi thekson: çështjen e bashkëpunimit e ke përmendur edhe më herët dhe tash e përmende dhe unë çdo herë kam qenë i gatshëm për bashkëpunim por ju ma keni futur emrin me një komision pa më pyetur dhe me gjithatë kam marr pjesë në takime dhe kur do që të më thirrni unë jam i gatshëm . Jam i gatshëm me ju kritikuar kur e keni keq por kur e keni mirë ju lavdërojë. Nëse një faturë mbi dyqind ditë nuk paguhet ose prej padijes e ka bërë , ose prej neglizhencës ose ka diçka që nuk po mundem me kuptuar. Është bërë pagesa pa u kryer projekti pra është shkelje ligjore por edhe mos pagesa e faturës është shkelje ligjore.

Nora Xhoni thekson: auditori nuk e zëvendëson as inspektoratin as policinë por jep vlerësime të pa varura siç i kemi në letër dhe jep rekomandime komunës dhe e përcjellë punën e brendshme , auditori ka rekomanduar për me u përmirësuar dhe nuk ka potencuar se ka shkelje ligjore por ka rekomanduar dhe për detyrë e ka ekzekutivi që me i përmirësuar rekomandimet e dhëna.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2025.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: në bazë të atyre të gjeturave të cilat i diskutuam kemi hartuar planin e veprimit, afat kohorë, veprimet të cilat duhet të ndërmerren. E gjetura e parë ka të bëjë me dobësinë për përgatitjen e raportit financiarë , pra do të merren masa dhe do të shtrohet kontrolli gjatë hartimit të pasqyrave vjetore financiare , në raportin financiarë vjetorë përgjegjës është drejtoria për buxhet dhe financa dhe drejtorit e tjera të cilat mbajnë data baza të ndryshme të cilat janë pjesë e pasqyrave vjetore financiare. E gjetura e dytë ka të bëjë me regjistrin e pasurisë por do të shtrohet kontrolli në regjistrimin e pasurisë si nën njëmijë euro dhe mbi një mijë euro , data e zbatimit të këtij rekoamndimi është dhjetorë 2026 , përgjegjës për këtë të gjetur është drejtoria për buxhet dhe financa dhe zyrtari për regjistrim të pasurisë . E gjetura e tretë ka të bëjë me klasifikimin e shpenzimeve dhe nuk është drejtë për drejtë shkelje nga komuna por kjo ka të bëjë me lëndët e kontratës kolektive të cilat janë ekzekutuar drejtë për drejtë nga thesari dhe kanë rezultuar si të gjetura edhe pse unë kam kërkuar që të hiqen këto si të gjetura për keq klasifikim të shpenzimeve por zyra kombëtare e auditimit ka marr vendim se edhe pse ne nuk jemi përgjegjës për ekzekutimin e këtyre lëndëve të mbetet në raportin e auditimit për vitin 2025 , data e planifikuar për zbatimin e këtij rekomandimi është dhjetorë 2026 . E njëjta është çështjen që ka të bëjë me vonesat e faturave dhe shpenzimeve tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari. Pra ka pasur raste që këto vonesa janë shkaktuar për disa planifikime apo plane të drejtorive të cilat kanë qenë në realizime sipër , në atë periudhë kohore mjetet të cilat janë ndarë për ekzekutimin e këtyre punëve , janë ekzekutuar lëndë të kontratës kolektive drejtë për drejtë nga thesari dhe me këtë rast këto nënprograme buxhetore kanë mbetur pa mjete dhe normalisht që është prolonguar ekzekutimi i faturave të cilat kanë qenë pjesë e atyre drejtorive për punë të ndryshme. Çështja e pestë ka të bëjë me mos themelimin e njësisë së auditimit të brendshëm , kushtet plotësohen sa i përket shumës totale buxhetore për planifikim të auditimit por nuk kemi pasur numër të lirë të stafit për të planifikuar një auditorë të brendshëm por do të bëjmë një përpjekje që të planifikojmë një pozitë për auditorë të brendshëm , nëse kjo do të aprovohet nga departamenti i buxhetit i Ministrisë së Financave . Kjo e gjetur planifikohet të realizohet për periudhën kohore janar - dhjetorë 2027.

Ferdi Topojani thekson: te njësia e auditimit të brendshëm që komuna jonë nuk e ka themeluar aty është data e zbatimit të rekomandimit janar -dhjetorë 2027 , a do të realizohet për vitin 2027 apo do të shtyhet edhe për ndonjë vit tjetër.

Visar Hasallari thekson: çështja e mos themelimit të auditorit të brendshëm , kanë kaluar gati tre muaj që kam parashtruar kërkesë që me pasur dokument zyrtarë për të cilin keni potencuar se ju kam adresuar Ministrisë por nuk e kam marr përgjigjen. Te plani i zbatimit të rekomandimeve keni potencuar se pasi ta bëni kërkesë për këtë pozitë do të bëhet plotësim ndryshimi i statutit të komunës dhe kërkohen dy të treta për me ndryshuar statutin dhe mbështetjen tonë si grup parlamentarë e keni por unë nuk e kam të qatë këtë se a rregullohet me plotësim ndryshim të statutit apo është vetëm një proces i thjeshtë i rekrutimit

Lindita Ballazhi thekson: i nderuar z.Topojani , është planifikim dhe është planifikuar që të realizohet në vitin 2027 pasi që në këtë vit nuk mund të realizohet pasi që brenda këtij viti nuk kemi ndonjë pozitë të aprovuar për të planifikuar nja auditorë të brendshëm për shkak se ajo shkon me një koeficient më ndryshe se sa këto pozitat të cilat i kemi aktualisht. Sa i përket vitit 2027 jemi në faza të planifikimit të buxhetit dhe unë do të kërkojë nga departamenti i buxhetit që të na aprovohet një pozitë e auditimit të brendshëm dhe nëse aprovohet atëherë do të vijojë faza tjetër që ne duhet ta ndryshojmë statutin e komunës për të krijuar një njësi të auditimit të brendshëm dhe kjo normalisht do të bëhet në Kuvend Komunal. Si ekzekutivë e kemi parashtruar një kërkesë bashkërisht në Ministri për shtimin apo aprovimin e disa pozitave që nuk janë aprovuar dhe përgjigja është vonuar pasi që unë nuk e kam atë kërkesë por me gjithë atë kam bërë kërkesa drejtë për drejtë me analisten buxhetore , me udhëheqësit në departamentin e buxhetit pasi që ne çdo vit e kemi forumin e autoriteteve komunale që e sqarojmë strukturën e shpenzimeve për vitin e ardhshëm. Unë gojarisht i kam parashtruar këto kërkesa tek ato që ne kemi mungesë dhe kam bërë kërkesë që të na aprovohet si pozitë që ne at heqim si rekomandim dhe ta kemi një auditorë të brendshëm.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

5. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërisë komunale.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: komisioni i vlerësimit i ka përfunduar të gjitha procedurat ligjore të dhënies në shfrytëzim afat gjatë të pronave të paluajtshme të komunës në pajtim me vendimin paraprakë të Kuvendit të Komunës. Bëhet fjalë për katër parcela dy në Pustenic dhe dy në Rezhancë. Interesimi për marrjen me qira të këtyre parcelave ka qenë i ulët. Për tre parcele nuk është paraqitur asnjë ofertë dhe për një parcele është paraqitur vetëm një ofertë pra oferta nga z.Bedri Imishti për parcelën 79 892-0 në Rezhancë i plotëson të gjitha kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të përcaktuara me njoftimin publik , andaj edhe e ka miratuar këtë ofertë. Përveç propozim vendimit në material e keni raportin përfundimtarë të komisionit vlerësues , keni njoftimin publik, procesverbalin nga hapja publike e ofertës, ofertën fituese si dhe njoftimin e shpalljes së fituesit. Gjatë realizimit të këtyre proceduarve nuk ka pasur ndonjë ankesë nga ndonjë palë.

Menduh Vlashi thekson: në emër të grupit parlamentarë të Aleancës deklarojmë se do të jemi kundër , jo pse jemi kundër këtij personi që e ka marr por ne kemi qenë prej fillimit kundër dhënies në shfrytëzim prandaj dhe vazhdojmë.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte 10 për 5 kundër.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PALUAJTSHMËRISË KOMUNALE

6. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2026.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson: përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam. Nëse keni ndonjë rekomandim që ne mundemi me diskutuar në mbledhje të KKSBB-së mund ta parashtroni.

Sead Vila thekson: e pashë informatën e KKSBB-së dhe vërtetë janë prekur të gjitha pikat të cilat ne po i diskutojmë si komunitet dhe mendoj që nëse merren me seriozitet këto pika, janë brengat dhe shqetësimet e qytetarëve që do të thotë janë probleme që ne ballafaqohemi çdo ditë , qoftë dukuritë negative, qoftë qentë endacak , qoftë zhurma apo problemet e tjera që kanë theksuar aty . Unë mendoj që edhe si komunitet edhe policia dhe të gjithë bashkërisht sa më shumë të bashkëpunojmë që me i zvogëluar ose së paku sa më shumë me u zvogëluar këto dukuri në dobi të qytetarëve të komunës sonë.

Menduh Vlasi thekson: unë i kuptoj çështjet që janë diskutuar dhe janë diskutuar kryesisht diskutimet të cilat janë bërë në KKSBB por unë kisha kërkuar që nga këto bisedime dhe kërkesa a ka pasur rezultate. Te çështja e investimeve kapitale që janë bërë investimet , a është marr ndonjë masë nga ana e policisë dhe a është zbuluar dikush që e ka dëmtuar pasurinë komunale. Është diskutuar çështja e dukurive negative dhe policia prej KKSBB-së ka obligim me dal me një qëndrim pra këtu nuk po shohë gjëra të tjera por po shohë se çka është biseduar që janë çështje që duhet të bisedohen vazhdimisht.

Ferdi Topojani thekson: te çështja e emigrantëve ilegalë çka është diskutuar dhe a është marr një masë për parandalimin e kësaj dukurie.

Mehmet Ballazhi thekson: është informatë për aktivitete KKSBB-së pra është informatë e jo raport për shkak se raportin e policisë e kam për çdo javë që ma përcjellin policia . Kjo është informatë dhe nëse jeni të interesuar ne mund tua sjellim raportin.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2026 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Menduh Vlasi thekson: në informatë shënon se janë pesë punëtorë teknikë , çka punojnë , ku punojnë dhe kush i pagan.

Hyreman Kuka thekson: dy punëtorë teknik janë te çerdhja, një është te ambulanta pra do të thotë se katër punëtorë kanë qenë kur kam ardhur dhe një e kemi pranuar.

Menduh Vlasi thekson: në raport e lexova që këta punëtorë paguhën prej mallrave dhe shërbimeve dhe realisht nuk duhet të paguhet paga prej mallrave dhe shërbimeve.

Mehmet Ballazhi thekson: punëtorët teknikë paguhën prej NPL Pastrimi dhe e kemi shtuar buxhetin këto çështje sepse ka nevojë për punëtorë dhe në kuadër të NPL Pastrimi bëhet pagesa. Neve na ka interesuar me kryer shërbime dhe për mënyrën e pagesë mos me pasur shkelje ligjore.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Informatë për sektorin e emergjencave.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Senad Kalisi thekson: përveç materialit të cilin e kam përcjellë diçka të veçantë nuk kam.

Shefket Lusnjani thekson: ju e dini se këto ditë ka qenë një erë e fuqishme dhe një banorit në fshatin Gorancë ja ka hequr kulmin e shtëpisë dhe është mirë që ti ndihmohet.

Senad Kalisi thekson: ne kemi qenë në teren dhe rastin e dimë por ka raste edhe të tjera të cilëve ju është dëmtuar kulmi i shtëpisë, për momentin nuk kemi ndonjë mundësi që kemi me mujt me ju ndihmuar por nëse ka ndonjë mundësi prej Ministrisë do ti shikojmë mundësit e tona se çka mundemi me ju ndihmuar.

Kryesuesi thekson: si drejtori a keni bashkëpunim me KEDS-in për shkak se po ka postime prej qytetarëve për çështjen e shtyllave elektrike.

Senad Kalisi thekson: kërkesë i kemi bërë KEDS-it për të gjitha shtyllat të cilat janë të nevojshme me u rregulluar por KEDS-i ka potencuar se do të kryhen.

9. Të ndryshme

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Resul Suma thekson: sa i përket donacionit që është dhënë nga Qatar Charity çka përfshihet nga projekti pra a do të bëhet vetëm ndërrimi i gypit apo shtimit të kapaciteteve të ujësjellësit. Edhe në mbledhjen e kaluar e kam ngritë si shqetësim çështjen e plotësim ndryshimit të rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe çështjen e rregullores për taksa administrative. Te rregullorja për subvencione neni 14 që potencon subvencionet në arsim dhe kategoritë dhe shumat e bursave do të përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës për çdo vit fiskal si dhe shumat e tjera të ipen me vendim të veçantë të kryetarit të komunës. Në bazë të konsultimeve me të gjitha grupet parlamentare ky vendim të i takojë kuvendit ashtu siç ka qenë me rregulloren e më hershme. Te rregullorja për taksa dhe tarifa administrative taksa për automjetet deri në tre pikë pesë tonë është në shumë prej dhjetë euro dhe automjetet mbi tre pikë pesë tonë është njëzet euro, në bashkëpunim me OVL-UÇK-në dhe në bashkëpunim edhe me komunat e tjera ku OVL-UÇK e ka pasur si kërkesë me i futë edhe veteranët e UÇK-së për largim nga kjo pagesë

Kryesuesi thekson: propozimin e z. Resul Suma e hedhë në votim që për mbledhjen e ardhshme të hyjë në rend të punës plotësim ndryshimit të rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

Mehmet Ballazhi thekson: ne jemi te pika e rendit të ndryshme dhe në KPF mund të përcaktohen pikat për kuvend. Më shumë është përgjegjësi e Kryetarit që me përcaktuar numrin e bursave për studentë dhe nuk është benefit dhe cili do të jetë benefiti i kuvendit. A është procedurë më e lehtë kur Kryetari merr një vendim me e rritur numrin e studentëve për subvencionim me një vendim apo është më e lehtë me bërë procedura, kërkesa të ndryshme që ka me komplikuar çështjen por nëse e shini të arsyeshme absolutisht pajtohem por kryetari e dinë më së miri sa është buxheti dhe si lëvizë dhe kjo është miratuar në Kuvend dhe e keni parë të arsyeshme dhe nëse ju e shihni si benefit miraton por nuk është benefit po është përgjegjësi më shumë,

Kryesuesi thekson: unë pajtohem me atë që potencon kryetari se është përgjegjësi se me të vërtetë është përgjegjësi por të paktën ta dimë se nëse merret një vendim për këtë vit sa është numri në të jetë aq e jo nëse përcaktohet numri pesëdhjetë pastaj me u bërë pesëdhjetë e një apo pesëdhjetë e dy. Vendimi do të merret në bashkëpunim me kryetarin e komunës tu u bazuar në mjetet financiare.

Mehmet Ballazhi thekson: kur është rritur numri i studentëve për marrje të bursave dikush ka pasur diskutime që me rritur shumën e bursës , mirëpo nëse më pyetni mu unë them që numrin me rritur për shkak se jo që ja mbulon gjitha shpenzimet sepse shumën edhe një mijë euro me ja bërë është pak për një studentë. Sa më shumë studentë me u përfshirë është më mirë që me u ni që së paka institucioni ka kujdesje për ta.

Menduh Vlasi thekson: nuk e dita që do ta propozon si pikë z.Resul Suma për shkak se në Komitet për Politikë e Financa shtohen pikat e rendit të punës . Unë e pata përgatitë këtë çështje dhe sot e përmbylli sepse kërkesa ime është qe gjashtë muaj dhe vazhdimisht kam potencuar se bartja e kompetencës , delegimi i kompetencës është shkelje ligjore por më keni neglizhuar, nuk mi keni sjellë raportet të cilat i kam kërkuar dhe tash në fund një pjesë që e kam kërkuar mi kanë dërguar dhe një pjesë e kam gjetur vetë dhe rezulton krejt diçka tjetër se çka kam menduar unë . Unë kam menduar se është bërë shkelje ligjore se nuk barten kompetencat e buxhetit te Kryetari i Komunës se buxheti është ekskluzivë kompetencë e Kuvendit të Komunës por kryetari me drejtorin e arsimit bënë propozim dhe kuvendi i komunës e miraton kur është në të mirë të studentëve. Është kompetencë ligjore e Kuvendit të Komunës dhe kuvendi duhet me marr atë vendim. Dokumentacionet i kam përgatitur dhe ka me i dërguar në prokurori se është bërë shkelje ligjore, është bërë mashtrim të publikut, janë bërë falsifikim të dokumentit. Në debatin publik drejtori i arsimit përveç që propozon rritjen e numrit të bursave nga katërdhejt deri në pesëdhjetë , nuk përmendë ndryshim të nenit katërmëdhjetë pikë dy dhe debati publikë e ka kuptuar vetëm rritjen e numrit, ndërsa në mbledhje është ndryshuar neni katërmëdhjetë pikë dy dhe në debat nuk e ka theksuar. E kam siguruar materialin prej anëtarëve të kuvendit të komunës prej mandatit të kaluar , materialin e mbledhjes së nëntë të vitit 2024 kur është miratuar plotësim ndryshimi i rregullores, përsëri të njëjtën gjë drejtori i arsimit i mashtron anëtarët e kuvendit të komunës i cili potencon se duhet me shtuar numrin dhe përmendë që duhet të harmonizohet pika shtatë me ministrinë që nga tre anëtarë me u bërë shtatë anëtarë por nuk e përmendë që do të bëhet plotësim ndryshimi i nenit katërmëdhjetë në kuvendë dhe kuvendi sigurisht e ka miratuar që nuk është bërë sqarimi dhe kryesuesi ka me qenë dëshmitarë por ose është mashtruar edhe kryesuesi. Atje duhet të shënohet se neni katërmëdhjetë potencon se numrin e bursave sasinë e përcakton kuvendi i komunës dhe nuk është shënuar që kjo fjali zëvendësohet me e përcakton kryetari por e përcakton Kryetari. Unë e kam përgatitur procesin e debatit, edhe procesin e kuvendit edhe propozim vendim dhe i kam kompletuar të gjitha dhe do të konsultohem me juristë mirë dhe do ta përcjelli në prokurori. Deri në mbledhjen e ardhshme nuk e përcjelli , nëse keni argumente të tjera që dikush prej ekzekutivit ka deklaruar se do ta ndërrojmë këtë pikë , atëherë pajtohem ashtu siç potencon Kryetari se Kuvendi ka marr vendim, nëse drejtori i arsimit e ka heshtur këtë pikë dhe vetëm e ka përmendur pikën tjetër dhe kuvendi është mashtruar dhe për atë po them vazhdimisht që lexone se çka jeni duke miratuar. Ne miratuar për mjetet e NPL Pastrimi por nuk e dishim as ku merren mjetet financiare dhe pastaj mundet me shënuar çka të doje pas. Kjo është nisra do ta vazhdojmë edhe me subvencionet e serrave sepse sipas informatave të cilat i kam nuk janë tetëdhjetë serra në Han të Elezit dhe më vonë do të dalim edhe në urbanizëm ku ka shkelje pasi që nuk po doni debat publikë në kuvendë kemi mundësi edhe tjera përmes prokurorisë.

Mehmet Ballazhi thekson: atë që potencova në fillim po ta them por e di që gatishmëri e jote është me krijuar hamulli , paragjykimi , me krijuar skena interesante unë kisha pritë prej secilit që ka ardhur për herë të parë në kuvend dhe i duken interesantë ama ty si skenaristë i më hershëm i këtyre tash po donë me nxjerr diçka që është krejtësisht ligjore. Ty rrafshin e hetimeve është kogja me përgjegjësi me zbuluar këtu dhe nëse ki e vendosë me dërguar në prokurori mund ta dërgoni.

Shefket Lusnjani thekson: kërkesë kam për drejtorin për shërbime publike, te deponia e fshatit Gorancë janë duke bërë keqpërdorime dhe a ka mundësi me vendosë një shejë. Duhet të bëhen analizat e ujit se e shihni që ka reshje atmosferike dhe duhet të bëhen në çdo gjashtë muaj.

Senad Kalisi thekson: do të shikohen mundësit se si mundemi me realizuar.

Nexhmedin Daci thekson: nuk është në rregull sepse jemi kolegë dhe jemi të këtij vendi sepse me sa jam në dioni drejtori i arsimit, kryetari por edhe ty jeni angazhuar sa më shumë me rritur numrin e bursistëve dhe kushdo që i thotë një kolegut tim mashtues nuk është gjuhë që duhet të përdoret sepse edhe ne mundemi me rënduar por mundet me potencuar që nuk e keni udhëhequr mirë këtë çështje e jo me potencuar që jeni mashtues për shkak se unë e di që kryetari i komunë ka biseduar me bizneset për me shtuar numrin e bursistëve e që kë ka mundur mos me u marr me këtë punë, ndërsa në kuvend dikush i thotë mashtues dhe nuk është mirë që follet me atë gjuhë . I përmendë disa herë çështjet në urbanizëm dhe ka bërë kërkesa për lejet ndërtimore ndërsa ky vetë nuk ka leje ndërtimore pra ka bërë ndërtim pa leje ndërtimore dhe parashtron pyetje se iks personi a ka leje ndërtimore dhe nuk është në rregull kjo se ky vetë ka punuar këtu. Dy mijë ndërtime janë pa leje në Han të Elezit dhe nuk fletë është mirë me biseduar si fenomen se pse ka ndodhur dhe pse ndodhin problemet pa leje dhe çka mundet me bërë komuna.

Menduh Vlasi thekson: unë nuk e kuptoj ndrysh dhe nëse ty e kupton ndryshe kërkoj falje por unë nëse qona para kuvendit dhe publikut e potencojë që kemi me bërë rritjen e numrit të bursave e në anën tjetër e shënojnë që me ndryshuar edhe nenin katërmëdhjetë a nuk është mashtim kjo.

Nexhmedin Daci thekson: me dashur me ndryshuar rregulloren mundemi kompletë se i kemi numrat në kuvend dhe nuk kam nevojë me bërë mashtim ashtu siç ty kanë votuar ty kur ke qenë në pushtet sepse i ke pasur numrat dhe nuk është mirë që me ju drejtuar ne me këtë gjuhë njëri tjetrit se je mashtues dhe keni bërë shkelej të ligjit që nuk e keni kryer një pagesë sepse ai ka pasur drejtë me një herë me dërguar në përmbarim.

Sherif Bushi thekson: te kjo pikë e rendit të punës do ti parashtrojë disa probleme e para ka të bëjë me deponitë e mbeturinave në komunën tonë dhe është bërë shprehje që disa mbeturina të hedhen pranë burimit të ujit të thartë dhe me një pjesë të rrugës që të dërgon në fshatin Pusteni . Përveç që paraqesin ndotje të natyrës edhe për pamje po dalin keq sepse po vërehen prej magjistrales. Ajo pjesë është pastruar shpesh herë nga punëtorët e NPL-Pastrimi por është mbushur përsëri me mbeturina , kërkoj që ajo pjesë të pastrohet. Kanalet e ujit për gjatë magjistrales gjatë gjithë kohës qëndrojnë të bllokuara dhe nuk e lejojnë që uji të kalojë në pjesën tjetër të magjistrales. Kur ka reshje atmosferike i gjithë uji kolonë në magjistrale dhe paraqet rrezik për të gjithë kalimtarët e sidomos për nxënësit të cilët shkojnë në shkollë e në të njëjtën kohë është problem edhe për shoferët, kërkoj që të pastrohen kanalet në mënyrë që mos të kemi probleme të tilla. Dua ta falënderoj stafin shëndetësorë të QKMF-së në Han të Elezit për punën që e bëjnë e sidomos në kohët e fundit që janë ballafaquar me një fluks të madh të pacientëve dhe në mënyrën më të mirë të mundshme e kanë bërë punën e tyre edhe pse ballafaqohen me mungesë të stafit.

Sead Vila thekson: ajo që po thirrmi ne vazhdimisht në bashkëpunim , harmoni dhe në të kundërtën po hezitojmë me mor fjalën se po kalohet në nënvlerësim dhe në injorim dhe kjo klimë e bashkëpunimit nuk na ka hije as neve si kuvendarë as si ekzekutivë. Mendoj që është mirë që secili prej neve me bërë një vetë vlerësim dhe reflektimi që me pasur kujdes e reagim dhe kritika mos të merret diçka si personale po ne të merret si diçka që ne e shohim keq e mund të bëhet më mirë e jo diçka që mund të kolonë personale. Drejtoria për kulturë a ka ndonjë aktivitet që është bërë për hir të diasporës në fushën e sportit edhe që për pjesën e kulturës gjithmonë e kum vlerësuar qoftë për festivalin por në muajin korrik dhe gushtë a ka pasur ndonjë planifikim. Cilët kategori lirohen nga legalizimi i shtëpive nëse për shkak se në mbledhje të komitetit për komunitete mora informacion se lirohen disa kategori. Nëse ka kategori që lirohen për pagesën e legalizimeve është mirë që të bëhet një njoftim sepse sikur qytetarët edhe unë nuk janë të njoftuar për këtë pjesë.

Arbenita Bajramaliu thekson: javën e parë të muajit gushtë e bëjmë njoftimin e aktiviteteve

Nexhmedin Daci thekson: nuk e di saktë që a në vitin 2022 apo në vitin 2023 kemi marr vendim që të gjitha kategoritë e dalura nga lufta të lirohen prej taksës komunale. Kushdo që është i interesuar me legalizuar shtëpinë mundet me ardhur dhe me pyetur , ne i kemi qit disa fletushka dhe shkrime kemi pasur edhe në fesbuk dhe interesime ka pasur. Kompania e cila është duke i kryer punimet i ka shkaktuar problemet me kanalizim atmosferik.

Senad Kalisi thekson: donacioni nga Qatar Charity përfshinë ndërrimin e gypave që e përfshijnë qytetin pjesën prej te Shelli dhe një pjesë mendojmë me kryer të Lagjia Uji i Thartë . Sa i përket hedhjes së mbeturinave inspektorët janë në teren dhe janë hedhë goma. Unë jam në kontaktet me inspektorët dhe kemi me vendosur një shejë .

Visar Hasallari thekson: kur është planifikuar me u mbajtur debati publik te zyra e Labit me kërkesën e kompanisë Sharrcem dhe nuk keni qenë të pranishëm dhe mungesa e qytetarëve në atë debat publik ka qenë shumë e madhe. Në atë debat ka marr pjesë vetëm Kryesuesi i Kuvendit të Komunës nga ana e legjislativit dhe e konstatuam se nuk ka pjesëmarrje të mjaftueshme për me mbajtur një debat për rolin dhe rëndësinë që do ta ketë ajo leje mjedisore . A do të kërkonte që të përsëritet ai debat sepse jemi dakorduar që me u përsëritur debati publikë dhe çfarë hapa të më tutjeshëm do të merrni në të ardhmen .

Mehmet Ballazhi thekson: ne nuk kërkojmë leje mjedisore por nëse dikush kërkon leje mjedisore , kërkon prej nesh një pëlqim ne e shohim të arsyeshme apo nuk e shohim mund të japim pëlqim, se leja mjedisore jepet nga Ministria e Planifikimit Hapësinorë . Mos pjesëmarrja në debat është e vullnetshme nuk është e detyrueshme. Më shumë e kisha parë të vullnetshme me pas debate ose dëgjime buxhetore pjesëmarrje të shumicë se sa për një leje mjedisore. Ai kërkon leje mjedisore janë mekanizmat qeveritarë që vlerësojnë atë se a duhet apo nuk duhet me i dhënë për djegiet e mbetjeve që ka dalë e gomave por është çështje e tyre se nuk jemi ne ekspertë por ata kërkojnë leje i japin arsyet e japin mënyrën e funksionimit dhe Ministria Vendosë dhe nëse du me marr pjesë në debat marr nëse nuk du me marr nuk e kam obligim.

Visar Hasallari thekson: unë e di shumë qartë se autoriteti që e jep atë vendim është Ministria e Mjedisit, mu personalisht mu kishte dokur shumë e natyrshme me qenë kryetari i komunës aty me parë atë draft raport për shkak se nuk është leje e lehtë dhe nuk është përdorur askund të Kosovë asi lloi i mekanizmit që me u përdorë për herë të parë në Han të Elezit dhe tash ajo leje bëhet gati që e kanë publikuar dhe është për afërsisht për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme që do të përdoret në kompaninë Sharrcem. Unë mendoj që kryetari i komunës duhet me qenë patjetër dhe në qoftë se nuk mundet së paku një përfaqësues prej ekzekutivit duhet me qenë aty.

Mehmet Ballazhi thekson: ty rekomandon që me marr pjesë ndërsa në anë tjetër thua që duhet patjetër por patjetër nuk e kam dhe nëse e shohë të arsyeshme , kam kohë mundet me shkuar apo nuk mundem me shkuar nuk më detyron ligji që me shkuar në atë debat. Me një debat që ka qenë më herët për të njëjtën çështje unë i kam përcjellë ekspertët e fushës që janë mundur me arsyetuar për me marr qatë leje por ju e dini që është keqpërdorë që komuna i ka lëshuar leje për përdorim të djegies së gomave se ishte atëherë politikë për me marr ndoshta ndonjë votë dhe nuk e kanë sqaruar që ne i japim leje kush do që kërkon me mbajtur një debat e që është e pa logjikshme mos me ja lejuar me mbajtur debatin e atë pëlqim për me mbajtur debatin neve na e kanë qit sikur i kemi dhënë leje për shfrytëzim. U keqpërdorë që unë e kuptojë për arsye dhe është shumë e ulët kjo, për ndryshe është çështje e tyre se a duan me kërkuar debat apo nuk duan.

Menduh Vlasi thekson: unë me kryetarin u pajtova tërësisht por ka fundi jo por me z.Visarin, hiq se në debatin e kaluar që e përmendi kryetari ka qenë edhe vetë , është potencuar se komuna ka lëshuar pëlqim dhe pa pëlqimin e komunës edhe Ministria nuk mundet me lëshuar lejen . Unë kam dokument që pëlqimi ju ka dhënë prej komunës . Nëse ju kujtohet vetë përfaqësuesi i Ministrisë ka potencuar se nuk di çka diskutojë kur komuna ka dhënë vetë pëlqim .

Mehmet Ballazhi thekson: po ta lexojë pjesën e parë të pëlqimit , Sharrcem Hani i Elezit , jepet në parim pëlqimi për studimin e mundësive për përdorimin e lëndëve djegëse alternative , pra na japim leje për studim, pra a është leje për djegëje pra a është pëlqim për djegëje apo për studim.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:43.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi

